



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 45/2020(JR)  
Nr. 45/2 regj.

Tiranë, më 18.11.2022

**SHPALLJE**  
**E**  
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit si dhe të gjithë personat e interesuar, se ditën e mërkurë, më datë **14.12.2022, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me numër nr. 45/2020 (JR), datë 15.10.2020, që i përket ankimit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit **Selim Kryeziu**, kundër vendimit nr. 278, datë 22.07.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesuese</b>	<b>Albana Shtylla</b>
<b>Relator</b>	<b>Sokol Çomo</b>
<b>Anëtare</b>	<b>Ina Rama</b>
<b>Anëtare</b>	<b>Natasha Mulaj</b>
<b>Anëtare</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARE**

  
**ALBANA SHTYLLA**  
